



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 733 Prot.

Tiranë, më 07 / 05 / 2021

V E N D I M

Nr. 75, Datë 07 / 05 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr. 45 Regj., datë 26.03.2021, të A. P¹, kundër Bashkisë Berat, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “bindjeve politike²”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, A. P ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë Berat (Bashkinë), në detyrën “Specialist për Sportet”, pranë Drejtorisë së Zhvillimit Strategjik dhe Integritimit Evropian, prej datës 06.04.2010 deri më datë 01.04.2020.

Ankuesi shprehet se: “Në muajin dhjetor 2020, në sheshin kryesor të qytetit të Beratit është zhvilluar një panair. Nga ana e një prej këshilltareve të Bashkisë më është dhënë si detyrë për të vendosur televizorin tek stenda e Bashkisë, për shkak se do të bëheshin prezantime për punët e realizuara nga Institucioni. Përveç TV më është dhënë edhe një USB me materialet që do të

¹ Përfaqësuar me Prokurë të Përgjithshme nga av. E. M.

² Referuar kartës së anëtarësimit në subjektin politik Parta Lëvizja Socialiste për Integritim (LSI), ankuesi ka provuar bindjet e tij politike.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën KMD.

shfaqeshin. Materiali përmbante prezantimin që kishte bërë Kryetari i mëparshëm Bashkisë, z. Petrit Sinaj. Pasi Kryetari i ri, pa materialin që po shfaqej në shesh, kujtoi se këtë veprim e kisha bërë unë qëllimisht dhe të nesërmen më thirri në zyrën e tij për sqarime”.

Subjekti ankues vijon në parashtrimet e veta, duke theksuar se që pas këtij incidenti, megjithëse nuk ishte përgjegjësia e tij, pasi ai kishte zbatuar udhëzimet e këshilltares, ndaj tij ishte ushtruar presion për të dhënë dorëheqjen nga detyra.

Ankuesi shprehet se nuk ka pranuar të japë dorëheqjen, pasi kishte 10 vite që punonte pranë këtij Institucioni dhe asnjëherë nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore, gjë që provon seriozitetin dhe profesionalizmin e tij në kryerjen e detyrës dhe se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës vetëm për shkak se ka bindje politike të ndryshme me Kryetarin e Bashkisë.

Z. P ka pretenduar se motivacioni i dhënë nga Bashkia, se largimi nga puna ka ardhur për shkak se vendi i tij i punës është shkurtuar nuk është i vërtetë dhe është i pabazuar, pasi, po të krahasohen dy strukturat e vitit 2019 dhe 2020 evidentohet lehtësisht se numri i punonjësve jo vetëm nuk është shkurtuar por kemi shtim të tyre nga 132 në 156.

Po ashtu, referuar strukturës së re, në numrin rendor XV të saj “Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Rinisë” është akoma në strukturë pozicioni i “Specialistit të Rinisë”. Ky pozicion, si dhe 25 pozicione të tjera të lira të cilat përkonin me kriterin arsimor të ankuesit, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Ristrukturimit për risistemimin e tij në punë.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të tij për shkakun e pretenduar, nga ana e Bashkisë Berat, si dhe rivendosjen e të drejtave të cënuara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e

Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁴, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të LMD-së, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr. 542/2 prot., datë 31.03.2021 Komisioneri ka njoftuar subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa, Bashkinë Berat dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
2. Me shkresën me nr. 1850/1 prot, datë 13.04.2021, Bashkia Berat ka sjellë parashtrimet e veta lidhur me çështjen në shqyrtim dhe dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Në parashtrimet e saj, Bashkia Berat ka argumentuar se, nëpërmjet Urdhrit nr. 209, datë 01.04.2020, të Kryetarit të Bashkisë, ankuesi është shkarkuar nga detyra “Specialist për Sportet”, pranë Bashkisë, me motivacionin e përfundimit të marrëdhënieve financiare dhe juridike të nëpunësit civil, për arsye të ristrukturimit të këtij Institucioni.

Bashkia ka mbajtur qëndrimin se, zgjidhja e marrëdhënies së punës është kryer sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për Statusin e Nëpunësit Civil”, duke siguruar barazinë e ankuesit para ligjit dhe trajtim të barabartë të tij me të gjithë punonjësit e tjerë.

Në përgjigjen e Bashkisë citohet se: *“Në asnjë moment ankuesi nuk është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ne nuk ishim në dijeni të bindjeve të tij politike dhe i kemi mësuar ato vetëm nëpërmjet shkresës së KMD-së. Me vendimin nr. 120, datë 21.02.2020 të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura e re e saj, dhe nga ky ristrukturim është prekur i gjithë Institucioni, përfshirë edhe Drejtorinë e Zhvillimit Strategjik dhe Integritimit Evropian, ku pozicioni që mbante ankuesi, në strukturën e re nuk ekziston më aktualisht. Komisioni i Ristrukturimit, i ngritur me Urdhrin nr. 118, datë 21.02.2020 të Kryetarit të Bashkisë, pasi verifikoi nëse mund të krijohej mundësia e sistemimit të punonjësve, ankuesit në këtë rast/ varësisht nga pozicioni dhe kualifikimi që kishin, në strukturën e re të krijuar apo në pozicione të barazvlefshme të lira, pjesë të Shërbimit Civil, gjykoj se për ankuesin nuk kishte asnjë mundësi transferimi, pasi nuk kishte asnjë pozicion të lirë në Shërbimin Civil, në të cilin ai të transferohej. Për sa më sipër, Bashkia ka ndjekur me përpikmëri të gjithë procedurën e largimit*

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

nga detyra të ankuesit dhe ka respektuar të gjitha afatet e përcaktuara në ligj. Nuk ekziston asnjë fakt që të vërtetojë se lirimi i tij nga detyra të jetë i lidhur me bindje politike të mundshme. Motivacioni i largimit është i njohur dhe i pranuar në legjislacionin në fuqi”.

Bashkia thekson se, ankuesin e ka trajtuar në mënyrë të barabartë me të gjithë punonjësit e tjerë, pa e diskriminuar.

3. Nëpërmjet parashtrimeve të e-mailit të datës 16.04.2021, dërguar KMD-së nga përfaqësuesja ligjore e subjektit ankues, Av. E. M, Komisioneri është vënë në dijeni të faktit se, ankuesi, pretendimin për diskriminim e ka bërë objekt të kërkesës së tij përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë (Gjykatës).

Nga akti bashkëlidhur e-mailit, konstatohet se, me datë 16.04.2021, subjekti ankues i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar: shtimin në objektin e kërkesë padisë, ndryshimin e shkakut të padisë, si dhe përfshirjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si palë e tretë në procesin gjyqësor kundër Bashkisë Berat.

Bazuar në kërkesën e depozituar në Gjykatë, evidentohet se në pikën e tretë të objektit të kërkesë-padisë është shtuar: *“Konstatimi i diskriminimit dhe shpërblimi i dëmit pasuror dhe jopasuror”*. Po ashtu, edhe thirrja e personit të tretë në gjykim, KMD-së.

4. Nëpërmjet letërthirrjes, datë 22.04.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë (Gjykata), KMD është thirrur si person i tretë, në procesin gjyqësor me palë paditëse, subjektin ankues dhe palë të paditur, Bashkinë Berat.

Gjykata i është drejtuar KMD-së, për paraqitjen e opinionit ligjor lidhur me rastin e A. P. Në këtë kontekst, rezulton që pretendimi i ankuesit për diskriminim nga ana e Bashkisë Berat, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe po shqyrtohet nga Gjykata.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak që bëhet prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ankues, në kërkesë padinë e paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e pabarabartë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit, për shkak të bindjeve politike, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes“, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 45 Regj., datë 26.03.2021, të A. P dhe deklaron pushimin e çështjes.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, **Komisioneri, vlerëson se jemi përpara rastit kur Gjykata e ka kërkuar atë, dhe KMD do përgatisë dhe paraqesë mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër, bazuar në fletëthirrjen datë 22.04.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.**

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë pushimin e çështjes me nr. 45 Regj., datë 26.03.2021, të subjektit ankues A. P, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Bindjet politike

Lloji i vendimit: Pushim shqyrtimi i çështjes/Po shqyrtohet në Gjykatë